

V E N D I M
Nr. 451, datë 26.9.2002

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”, ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen II-A, në kreun II “Shtesa të tjera”, në fund të pikës 4 të shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“-Punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve t’u jepet një shtesë, për natyrë të veçantë pune, përkatësisht, drejtorit 10 për qind, përgjegjësit të sektorit 15 për qind dhe specialistëve 25-35 për qind.

- Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit që për caktimin e shtesës mbi pagë të nxjerrin udhëzimin përkatës.”.

2. Në paragrafin e fundit të pikës 5, fjalët”... dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit...” shfuqizohen.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shtator 2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano